



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:120082
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05342059

C.nr.1317/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështje juridike kontestimore të paditësit Z.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson E.Gj. avokate nga Prizreni, kundër të paditurit A.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson R.K. avokat nga Prizreni, me objekt kontesti: Vërtetimin e pronësisë, me datën 16.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridiko- kontestimore sipas padisë së paditësit Z.M. nga Prizreni, kundër të paditurit A.M. nga Prizreni.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj pas zgjidhjes së çështjes paraprake tek gjykata në çështjen jokontestimore me shenjë CN.nr.470/2021.

A r s y e t i m

Paditësi Z.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi kundër të paditurit A.M. nga Prizreni, me objekt kontesti: Vërtetimin e pronësisë.

Gjykata, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit kontestimor, ka caktuar seancën për shqyrtimin përgatitor të datës 14.02.2024, në të cilën kanë prezantuar e autorizuara e paditësit E.Gj. avokate nga Prizreni dhe i autorizuarit të paditurit R.K. avokat nga Prizreni. Në këtë seancë përgatitore, i autorizuarit të paditurit ka kërkuar që procedura gjyqësore lidhur me këtë çështje kontestimore të ndërpritet për derisa nuk përfundon procedura jo kontestimore për ndarje fizike të bashkë pronësisë. Po ashtu edhe e autorizuara e paditësit nuk e ka kundërshtuar propozimin e të autorizuarit të paditurit që procedura kontestimore në këtë çështje të ndërpritet pasi që çështja e ndarjes fizike në mes të paditësit Z.M. dhe bashkëpronarit tjetër E.D. në këtë çështje paraqitet si çështje paraprake.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 278, par.1, pika a) të LPK-së, ku parashihet që: *“Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin: a) po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji)”*, pasi që zgjidhja e çështjes jo kontestimore në mes të paditësit Z.B. dhe bashkëpronarit tjetër E.D. për ndarjen fizike të paluajtshmërisë, me shenjen CN.nr.470/2021, paraqet çështje paraprake dhe me përfundimin e kësaj çështje do të përcaktohet legjitimiteti aktiv i palës paditëse në këtë çështje kontestimore. Ndërsa në nenin 280 par.3 parashihet që *“Po që se gjykata e ka ndërprerë gjykimin nga shkaqet e përmendura në nenin 278 paragrafi 1 pika a) dhe paragrafi 2 të këtij ligji, gjykimi do të vazhdojë pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek gjykata apo organi tjetër kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj”*.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të lartcekurave, erdhi në përfundim se procedura në këtë çështje juridike duhet të ndërpritet, pasi janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 278 par.1, pika a), neni 280.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1317/2018, të datës 16.02.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.